

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Gjyqtari Agim Kuçi me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Ibadete Sylja, në çështjen penale, kundër të pandehurit, M.F nga fshati P, Komuna e O, i akuzuar për shkak të veprës penale, Falsifikim i Dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, me shenjë, PP.II.nr.2856-11/2011, të dt.22.03.2012, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të hapur, të mbajtur në dt.23.03.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit Naim Abazi, të akuzuarit M.F dhe mbrojtësit të tij, sipas autorizimit, av.G.H, në bazë të nenit 365 dhe 366 par 1 të KPPRK-së, në dt.23.03.2016, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri-M.F, nga i ati R dhe nëna N, mbiemri i vajzërisë Sh, i lindur me *data e lindjes*, në fshatinë P, Komuna e O ku edhe jeton, me nr. Perosnal *numri personal*, ka të kryer shkollën fillore, i martuar baba i 4 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, Ashkali, Shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

S e p s e:

Ka përdorur patentë shoferin e Serbisë, si dokument publik të vërtete, edhe pse e ka ditur se nuk është i tillë, ashtu që me dt.17.11.2010, në fshatin P, është ndalur nga Policia e trafikut dhe kur ia kërkojnë dokumentet e automjetit, atyre ua tregon patentë shoferin e Serbisë me numër serik CP, i lëshuar në N B, me dt.22.05.2004, e për të cilin pas ekzaminimit u vërtetua se ishte i falsifikuar.

- me këtë ka kryer veprën penale Falsifikim i Dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit të cekur më lart, neneve, 4, 7, 23, 46, dhe 73 të KPRK, si dhe nenit 365, 366, të KPPRK, i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Dënim me Gjobë

Ashtu që të akuzuarin M.F, e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej **400 (katërqind)** euro, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Obligohet, i akuzuari që ti paguaj shpenzimet procedurale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, si dhe në emër të paushallit gjyqësor, gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

Konfiskohet patentë shoferi i Republikës së Serbisë, me nr. Serik.....

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën me shenjë, PP.nr.2856-11/2011, të dt.22.3.2012, e ka akuzuar M.F nga fshati P, Komuna e O për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par 3 lidhur me par 1 të KPK, dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri, vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor dhe të njëjtin me aktgjykimin me shenjë, P.nr.47/16, të dt.1.2.2016, e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro.

I akuzuari brenda afatit të përcaktuar ligjor ka ushtruar kundërshtim ndaj aktgjykimit të lartcekur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe shkëljes së të drejtës materiale.

Gjyqtari i vetëm gjykues në dt.23.3.2016, ka caktuar shqyrtimin gjyqësor në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin Prokurori i Shtetit Naim Abazi, i pandehuri M.F dhe mbrojtësi sipas autorizimit av. G.H.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor gjyqtari e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tij sipas nenit 323 të KPRK. I pandehuri ka deklaruar se i kupton të drejtat e lexuara. Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës me shenjë, PP.nr.2856-11/2011, të dt.22.3.2012. Pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të pandehurit iu dha mundësia që të pranoj ose jo fajësinë.

I pandehuri është deklaruar i pafajshëm.

Pasi që i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë është vazhduar me fjalën hyrëse të palëve. Pas fjalës hyrëse është vazhduar me leximin e provave të paraqitura nga Prokuroria, dhe me marrjen në pyetje të të akuzuarit.

Në pyetjet e Prokurorit të Shtetit i pandehuri deklaroi: Se patentë shoferin për të cilin akuzohem e kam marrë në vitin 2004, nuk më kujtohet data, për këtë patentë i kam dhënë 330 (treqind e tridhjetë) euro, dhe të njëjtin nuk e kam legalizuar pasi që vajzën e kam pasur të sëmurë. Po ashtu, i pandehuri deklaroi se emri i auto shkollës nuk më kujtohet por e di se ka qenë auto shkollë private, ku unë nuk i kam mbajtur orët e vozitjes pasi që kam ditur të vozisë dhe se nuk më kujtohet emri i instruktorit të asaj shkolle.

Mbrojtësi i të pandehurit nuk ka pyetje.

Në pyetjet e gjyqtarit i pandehuri përgjigjet se vet ka shkuar që ta marr lejen dhe se atë e ka pranuar personalisht, ku së bashku me të kanë qenë edhe tre shokë të tjerë, edhe ata nga fshati Plemetinë. Pas prezantimit të provave dhe marrjes në pyetje të të pandehurit, gjykata kaloi në fjalën përfundimtare.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare mbeti prapa akuzës së dt.22.3.2012, me arsyetimin se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor u vërtetua se i njëjti me dashje me qëllim të përfitimit ka falsifikuar dokumentin-patentë shoferin e Republikës së Serbisë, me nr.CP 06194174, i cili patentë shofer u vërtetua se është tërësisht i falsifikuar dhe kërkojmë nga gjykata që të njëjtin ta dënoj sipas ligjit ndërsa dokumentin e falsifikuar ta konfiskoj.

Mbrojtësi i të pandehurit av.G.H në fjalën përfundimtare deklaroi: Në seancën e sotme nuk u vërtetua se i mbrojturi im e ka kryer veprën penale për cilën akuzohet pasi që i njëjti është nënshtruar provimit të testit, të praktikës si dhe të ndihmës së parë dhe se me dt.22.5.2004, e ka dhënë provimin për patentë shofer. Konsideroj se nuk është faji i tij se ndoshta dikush tjetër e ka vënë në lajthim nga organet e Republikës së Serbisë dhe i kanë ofruar patentë të falsifikuar, dhe i propozon gjykatës që të njëjtin ta liroj nga akuza ose nëse gjykata gjen se i pandehuri ka kryer vepër penale të njëjtit ti shqiptoj një dënim të kushtëzuar, duke marr për bazë gjendjen ekonomike të dobët.

I pandehuri në tersi e përkrahu fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Duke i proceduar provat e nxjerrura në procedurë një nga një dhe në lidhjen e tyre të ndërsjellë, në bazë 7 par 1 dhe 361 të KPPRK, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se i pandehuri M.F ka përdorur patentë shoferin e Serbisë, si dokument publik të vërtete, edhe pse e ka ditur se nuk është i tillë, ashtu që me dt.17.11.2010, në fshatin P, Komuna e O, është ndalur nga Policia e trafikut dhe kur ia kërkojnë dokumentet e automjetit, atyre ua tregon patentë shoferin e Serbisë me numër serik CP, i lëshuar në N B, me dt.22.05.2004, e për të cilin pas ekzaminimit u vërtetua se ishte i falsifikuar.

Gjendjen e këtyre faktike, respektivisht se patentë shoferi të cilin e posedonte i pandehuri është i falsifikuar, gjykata e ka vërtetuar nga Raporti i Ekspertizës i dt. 17.3.2011, sipas të cilit raport konstatohet se patentë shoferi me nr. serik, është plotësisht i falsifikuar.

Pas veprimeve të ndërmarra, Gjkata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në KPK-së, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të të pandehurit, është i papunë, baba i 4 (katër) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa rrethana veçanarisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 41 par 1 dhe 2 të KPK-së, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara.

Vendimi për kompensimin e paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par 1 dhe 2 nën par 2.1 dhe 2.6 të KPPK.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.47/16, dt.29.3.2016.

Procesmbajtësja

Gjyqtari

Ibadete Sylja

Agim Kuçi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.